

BIBLIOTEKA


E

331.88(416.5)

SHTETIT

B 80

GJIROKASTËR



MAQINAT
të mës
pushojnë

FANE BOSHINJAKU

331.88(456-5)

S

B 80

FANE BOSHNJAKU

«MAQINAT TË MOS PUSHOJNË»

— Lëvizje me përmbajtje të thellë ideologjike, që
revolucionarizon njerëzit, shpie përpara prodhimin. —

40059

LIBRARI E SHTETIT
SHKURTAR

~~33.11.86~~

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

**«Partia, duke ngritur në këmbë ma-
sat, duhet të kapë përnjëherësh të renë,
ta përgjithësojë e ta zhvillojë atë më tej
e në mënyrë të rrufeshme».**

ENVER HOXHA

*(Nga fjala «Mbi rendimentin e pu-
nës dhe disiplinën proletare në punë»,
mbajtur në Plenumin e 9-të të Komi-
tetit Qendror të PPSH, datë 27 dhje-
tor 1969).*

NJERËZ TË RINJ TË UZINËS SE RE

Iniciativa me përmbajtje të thellë ideologjike dhe ekonomiko-shoqërore «Maqinat të mos pushojnë» lindi në uzinën e re, të krijuar në vitet e vrullshme të punës për plotësimin e planit të katërt pesëvjeçar, pikërisht vetëm disa muaj pas vendimeve të rëndësishme të Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror të PPSH dhe fjalës programatike që mbajti shoku Enver Hoxha në këtë plenum: «Mbi kooperimin dhe revolucionin tekniko-shkencor».

Pas këtij plenumi, mendimi krijues i masave për të krijuar reparte, linja, fabrika, madje edhe uzina të reja u ngrit në një shkallë më të lartë, u shpreh me një forcë edhe më të madhe. Punëtorët e uzinës «Partizani», ku bënte pjesë edhe reparti, mbi bazën e të cilit lindi, u rrit, u zhvillua dhe mori fizionominë e vet uzina e re «Dajti», prej kohësh studjonin, këshilloheshin me njëri-tjetrin dhe në këtë ose atë formë kishin bërë edhe ndonjë propozim për të prodhuar këtë ose atë material higjeno-sanitar për ndërtimet, ose për të zëvendësuar këtë ose atë prodhim që sillej nga jashtë. Ndonjëri kishte hartuar edhe ndonjë skicë të zbetë.

kishte bërë edhe ndonjë eksperimentim, por përsëri nguronte ta shfaqte, sepse ende mungonte besimi në vetëvete.

Në prag të plenumit u bë një konsultë e gjerë, ku shpërthyen shkëndiat e para të iniciativave, mirëpo kjo ishte vetëm faza e parë, kryesisht e propozimeve të mbyllura. E themi të «mbyllura» se ato kufizoheshin vetëm në gamën e caktuar të prodhimit të mëparshëm, sidomos në përmirësimin e cilësive. E megjithatë ato ishin grumbullim i gjithanshëm i përvojës, i rrahjes së mendimeve për t'i dhënë një zhvillim të ri forcave prodhuese. Ato i ndihmuan punëtorët e vjetër dhe të rinj që, menjëherë pas punimit të vendimeve të Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror të PPSH dhe fjalës së shokut Enver në këtë plenum, të shpërthenin në punë krijuese për të mekanizuar e specializuar repartin e tyre, për ta zgjeruar gamën e prodhimit, për të modifikuar shumë maqineri, për të krijuar maqineri të reja, për të përmirësuar cilësinë.

Punëtorët e rinj, si pjesa më dinamike e kolektivit, megjithëse me përvojë jo shumë të pasur profesionale, ju vunë punës për të mbajtur fjalën e dhënë në mbledhjen e kolektivit se do të zgjeronin pjesëmarrjen e tyre në revolucionin tekniko-shkencor, do të rrisnin aftësitë e tyre profesionale, do të mësonin sa më shumë nga përvoja e punëtorëve të vjetër, sidomos nga shprehitë e tyre profesionale, nga dashuria e tyre për punën.

Bashkëpunimi i ngushtë me punëtorët e vjetër dhe personelin inxhiniero-teknik, thyerja e mendimit të disa punëtorë të rinj se «ne i dimë më mirë të fshehtat e zanatit se sa një punëtor më i vjetër», se «e kemi mësuar profesionin me shkollë», si

dhe qëndrimi kritik, që u mbajt ndaj mendimeve konservatore të ndonjë punëtori të vjetër, dhanë përfundime të mira. U forcua bashkëpunimi midis punëtorëve, u studjua bashkarisht se çfarë mund të bëhej për të zgjeruar gamën e prodhimeve, se çfarë artikujsh të rinj mund të prodhoheshin në kooperim me ndërmarrjet «motra».

Ashtu i bashkuar, nën udhëheqjen e organizatës bazë të partisë, gjithë kolektivi ju përvesh punës krijuese. Secili përpiquej të mësonte, të shpikete, të krijonte, me besim të patundur në forcat e veta, në fjalët e shokut Enver: «Çdo gjë mund ta bëjnë njerëzit tanë njëlloj si nga më të mirat e vendeve të tjera, mjaft që të zhvillojnë më tej mundësitë e punës e të studimit». Nuk mbeti pjesëtar kolektivi që të mos tregonte iniciativë, zgjuarësi e aftësi në zgjidhjen e detyrave të përditshme që i dilnin uzinës së re. Dhe fruti i mendimit krijues, i përpjekjeve kolektive të organizuara nuk vonoi të dukej. Brenda 5 muajve nga dita e inagurimit të uzinës u ngrit masivi i studimit dhe i eksperimentimit, byroja teknologjike konstruktive me aktiv të gjerë punëtorësh, u përfunduan dhe filluan nga prodhimi 16 reparte dhe sektorë të rinj, u prodhuan 20 maqineri e pajisje kryesore, me dhjetëra stampa për mekanizimin e prodhimit, u dhanë për shfrytëzim 7 sektorë higjeno-sanitarë dhe kulturalo-arësimore, si mensa, shkolla, garderoba, infirmieria. Planet mujore u realizuan 100-110 për qind.



Konsulta për përhapjen e iniciativës
«Maqinat të mos pushojnë»

I entuziazmuar nga sukseset e arritura, vetë kolektivi dyfishoi planin e prodhimit për vitin 1969. Njëzëri u vendos të ngriheshin 6 reparte dhe sektorë të tjerë prodhimi, të dyfishohej numri i artikujve dhe i asortimenteve të rinj të ndërtimit, të prodhoheshin mbi 30 maqineri e pajisje kryesore dhe mbi 140 pajisje e stampa për mekanizimin e prodhimit e artikujve të rinj.

Vështirësitë për t'i dalë mbanë kësaj pune nuk ishin as të pakta, as të lehta. Rreth 80 për qind e punëtorëve nuk zotëronin asnjë kategori. Baza e maqinerisë që ende e dobët. Një pjesë e maqinave nuk ishin në gjendje pune. Presat kryesore pritëshin të vinin nga jashtë.

Si duhej vepruar? Çfarë duhej bërë që po me ata punëtorë, po me ato maqineri të plotësohesh plani i dyfishuar? Ja çfarë e shqetësonte kolektivin e uzinës së re.

Këto vështirësi të rritjes, të ecjes përpara, u diskutuan gjerësisht në organizatën bazë të partisë, e cila, duke pasur parasysh përbërjen e kolektivit të uzinës, u bëri thirrje punëtorëve të vjetër që t'ua jepnin pa ngurim përvojën e punës së tyre punëtorëve të rinj. Ndërkaq ajo shtroi përpara punëtorëve të rinj detyrën që të mësonin në punë, në praktikë dhe në libër. Organizata e rinisë e diskutoi këtë detyrë dhe mori masa konkrete për ta vënë në jetë. Të rinjtë u regjistruan në kurse, ndiqnin me kujdes punën e shokëve të tyre, lexonin literaturë teknike, pyesnin pa pushim teknikët, inxhinierët, diskutonin në kohën e pushimit dhe vazhdimisht mendonin se çfarë mund të bënin.

Mbi bazën e sukseseve të arritura, të përvojës së fituar, lindi iniciativa «Maqinat të mos pushojnë».


Liri Hitocani, sekretare e organizatës së rinisë së uzinës, tregon:

«... Maqinat kryesore për ne, presat ekrentike, ende nuk po vinin nga jashtë. Plani i dyfishuar kishte rrezik të mos realizohej. A mundet ta lejonin këtë të rinjtë? Ndokush mund të mendojë: «Kjo detyrë nuk u përket të rinjve. Ata nuk janë as planovikë, as shefa furnizimi». Po nuk është kështu. Mbi të gjitha, të rinjtë, si gjithë punëtorët, janë zotër të uzinës, bij të denjë të partisë, të popullit, luftëtarë aktivë të socializmit. Duke qenë të tillë, ata në asnjë mënyrë nuk mund të men-

donin se ka kush merret me problemet e prodhimit».

Kurrë të rinjtë e kësaj uzine nuk e kanë ndjerrë veten të veçuar nga kolektivi, nga problemet e tij. Edhe kësaj radhe e ndjenë thellë përgjegjësinë për realizimin e planit.

Në organizatën e turnit A të repartit të presave u ndezën debate: si duheshin shfrytëzuar më mirë koha e punës dhe maqineritë.



Në këtë repart lindi shkëndia «Maqinat të mos pushojnë»

Punëtorët pararojë të uzinës së re «Dajti» Zenepe Sala, Alberta Sadikaj, bashkë me një grup shoqesh e shokësh, kishin kohë që bisedonin për ta përsosur më tej organizimin e «vogël» të punës në repartin e presave. Ato i shqetësonte fakti që

presat gjigande qëndronin pa punë në kohën e pushimit ose kur një punëtor plotësonte një shërbim, detyrë shoqërore, apo kur bënte lejen e zakonshme.

Me këtë grup punëtorësh vazhdonte rregullisht studimi i dokumentave të partisë dhe i veprave të shokut Enver. Në fillim studimi nuk lidhej sa duhej me problemet e ndërmarrjes dhe nuk nxirrreshin detyra për ta përmirësuar më tej punën në repart e uzinë, mbi bazën e këtyre studimeve. Në kohën kur po punohej fjala e shokut Enver në Plenumin e 3-të, disa punëtorë, me qëllim që të konkretizoheshin më mirë detyrat, kërkuan që të pregatitej i gjithë kolektivi për diskutim. Dhe kështu u veprua. Kolektivi, një javë pas leximit të fjalimit programatik, u mbledh përsëri të diskutonte konkretisht mbi disa nga problemet e revolucionit tekniko-shkencor. U shpjegua çfarë do të thotë zhvillim në thellësi i industrisë, u treguan rrugët si mund të materializohet në uzinën e re parimi i mbështetjes në forcat e veta, etj. Diskutimi masiv shërbeu për njohjen më të mirë të problemeve kryesore të uzinës. Çdo punëtor, atë që më parë e kishte menduar vetë, filloi ta diskutojë edhe me shokët e punës, të brigadës. «Më parë, — thotë Zenepe Sala, — ne shpesh i nënvleftësonim aftësitë tona, duke thënë se problemet e organizimit e të drejtimit të prodhimit janë punë të mjeshtrave, inxhinierëve e drejtuesve të ndërmarrjes. Pas studimit të fjalës së shokut Enver filluam ta quanim veten jo thjesht njerëz që vëmë në lëvizje maqinën, po edhe njerëz që mund ta krijojmë këtë, t'i zgjatim jetën, ta përdornim në

mënyrë sa më racionale. Ja kështu lindi edhe mendimi mbi lëvizjen «Maqinat të mos pushojnë».

Inciatorët vendosën që, duke forcuar punën me radhitës, edhe gjatë 30 minutave të pushimit të punëtorëve maqinat të vazhdonin të punonin. Ato i ranë kalemit. Doli se vetëm nga 6 presa dhe vetëm nga shfrytëzimi i kohës së pushimit gjatë ngrënjes në një turn fitoheshin 3744 orë në vit. Po për turnet e tjera, për uzinën?

Në fillim lëvizja nisi në formë eksperimentale, pa bujë, por kur u pa se ajo kishte mundësi të përhapej edhe në presa e maquina të tjera, u fol gjerësisht. Shumica e punëtorëve, të cilët në hesh-tje kishin ndjekur rezultatet e punës, jo vetëm që u dhanë zemër iniciatoreve, po filluan të përqafonin edhe vetë lëvizjen.

Përmbajtja e thellë ideologjike dhe tekniko-shoqërore e lëvizjes së re gjen shprehjen në faktin se punëtorët merren aktivisht me problemet e organizimit të prodhimit.

Lëvizja e re thellon karakterin krijues të punës. zbulon dhe tërheq në procesin e prodhimit rezervat e brendshme, që gjenden në fushën e përdorimit të mjeteve të prodhimit. Ajo i shërben rritjes së shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese të uzinës, duke rritur në të njëjtën kohë edhe rendimentin e punës për çdo makinë. Gjithashtu ajo krijon kushte reale për kualifikimin masiv të punëtorëve me profesione të dyta, pa shkëputje nga puna, dhe zgjeron më tej sferën e këmbimit të përvojës në punë midis punëtorëve.

Të shfrytëzohen maqineritë edhe gjatë kohës që punëtori i maqinës pushon për nevojat vetiake, siç janë pushimi për ngrënje, për paaftësi të për-

kohshme në rast sëmundjeje, për leje vjetore, për pregatitje ushtarake, etj.

Ja, thelbi i iniciativës. Kësaj do t'i arrihej nëpërmjet dy rrugëve: së pari, *punëtorëve të presave do t'u shtohet edhe një radhitës për të kryer gjithë punën ndihmëse, gjë që do të rriste shfrytëzimin e kohës së punës 15-20 për qind, dhe, së dyti, gjatë kohës së pushimit të punëtorëve për ngrënje, maqinat do të vazhdonin punën me punëtorë që zotëronin dy profesione.*

E reja fiton në luftë me të vjetrën konservatore.

Lindi pra një lëvizje e re, me përmbajtje të thellë ideologjike. Po si çdo e re tjetër, edhe ajo u ndesh që në «djep» me të vjetrën. Dhe kjo pri-tej. E reja, lind e lulëzon, po edhe e vjetra qëndron e reziston, shpesh duke ndryshuar format e luftës e duke u maskuar me «rrobat» e së resë.

Nisën të dëgjoheshin zëra: «Ama për iniciativë! Kësaj i thonë të ndahesh nga shokët, të hashë bukë veç». «Na dolën yste». «Në asnjë uzinë s'veprohet si te ne». «Kështu e na mungon lënda e parë e materialet, po kur maqinat të mos pushojnë!?» «Edhe pse s'kanë shpirt ato kanë nevojë për çlodhje». «I gjori përgjegjës reparti ç'do të heqë me lista e grafike». «Të shkretat maqina! Ndhimësat në vend që t'u venë vetullat, do t'u nxjerrin sytë».

Ç'duhej bërë që të hidheshin poshtë këto koncepte, që shkëndia e ndezur të mos shuhej si flakë kashte, po të fuqizohej e të përhapej në tërë uzinën?

Në mbrojtje të së resë u vunë që në fillim

organizata bazë e partisë dhe, nën shembullin e udhëheqjen e saj, bashkimet profesionale, bashkimi i rinisë. U kombinuan veprimet, u kap hallka kryesore: puna me njerëzit, sidomos me të rinjtë e të rejtat, që përbënin pjesën më të madhe të kolektivit e që nga vetë natyra e tyre janë më të gatshëm për të ndjekur shembullin komunist, për të përqafuar të renë, për të rritur krenarinë e uzinës së re, lavdinë e kolektivit. Ishte fjala për të zgjidhur probleme të revolucionit tekniko-shkencor dhe rinia, ashtu siç porosit shoku Enver, duhej të bëhej shtylla e këtij revolucion.

Rinia mund të çajë me sukses përpara kur i besohet plotësisht, kur orientohet drejt dhe inkurajohet e udhëhiqet vazhdimisht nga organizatat e partisë. Këtë dëshmon edhe përvoja e uzinës «Daj-ti».

Iniciativa e lindur në repartin e presave duhej përhapur. Duke vënë në jetë orientimet e organizatës bazë të partisë dhe duke siguruar udhëheqjen e saj, të rinjtë iniciatorë kaluan nga një repart në tjetrin, folën për përmbajtjen, kushtet dhe dobinë e lëvizjes.

Të parët që e përqafuan lëvizjen ishin të rinjtë e plasmasit, saraçineskave, të cilët bënë mbledhje të veçanta të organizatës.

Puna filloi të ecte mbarë. Iniciativa lindi iniciativën. «Të mos presim në një presë të madhe 60 tonshe një detal që ka mundësi të pritët me një presë 20-25 tonshe». Edhe për këtë u bë një diskutim i zjarrtë, që përfshiu jo vetëm të rinjtë, po gjithë kolektivin. Shfrytëzimi i kohës, i maqinerve po bëhej problem i të gjithëve.

Nganjëherë puna çalonte; lëvizja harrohej. Ndonjë maqinë nuk shfrytëzohej plotësisht ose për arësye difekti, shkaktuar nga puna «shkel e shkonë» në remont, ose nga mospregatitja në kohë e stampave. Më shpesh lëvizja pengohej nga ata që nuk merrnin pjesë drejtpërdrejt në prodhim, po që kishin të bënin shumë me të, siç janë punonjësit e furnizimit, të planit, të llogarisë.

Të rinjtë u hodhën me guxim në luftë të vendosur kundër rutinës burokratike dhe pengesave të tjera brenda dhe jashtë uzinës. Për problemet që zvarriteshin, siç ishte furnizimi me lëndë të parë dhe ndihmëse, ata ngrinin zërin, sipas rastit, në organizatat e partisë, drejtoritë e ndërmarrjeve, në organet lokale të pushtetit dhe gjer në dikasteret qendrore. Dhe ata nuk vepruan keq. Në këtë mënyrë plotësuan një detyrë, gëzuan një të drejtë.

Debatet me fletrrufetë, ballafaqimet, takimet e ndryshme, mbledhjet e zjarra, pjesëmarrja aktive në ushtrimin e kontrollit punëtor, tërë lufta për të fuqizuar e përhapur lëvizjen «Maqinat të mos pushojnë» e kaliti rininë, e vuri atë në pozita më luftarake dhe rriti iniciativën dhe vetëveprimin e organizatës.

Të rinjtë e të rejat, ashtu si gjithë punëtorët e tjerë, në tërë veprimtarinë e tyre u udhëhoqën nga shembulli i komunistëve, të cilët, pasi plotësonin me sukses detyrën që shtronte lëvizja në vendin e tyre të punës, propagandonin rëndësinë e saj në të tjerët, kërkonin nga ata ta përqaфонin. Kur vetë je në rregull, e ke lehtë të flasësh, t'u bësh thirrje të tjerëve, t'i bindësh ata. Ndryshe, të vepruarit sipas parimit «bëni si them unë e

mos bëni si bëj unë» i kthen porosinë në thirrje të kota, në zëra në shkretëtirë.

Shpirti sulmues, fryma luftarake e të rinjve, e gjithë punëtorëve dëshmoi edhe kësaj radhe vërtetësinë e fjalëve të shokut Enver: «Partia, me vijën e saj të drejtë, me hov revolucionar, bën që procesi i zhvillimit socialist të vendit të mos ndërrohet në një proces burokratik, por vetë të thonë kurdoherë dhe në çdo etapë fjalën e tyre klasa punëtore dhe masat punonjëse, pasi janë ato që veprojnë, që transformojnë, që krijojnë».

PROPAGANDA PRIN

«Porsa fillon procesi i punës, duhet të fillojë njëkohësisht edhe propaganda, bile kjo është ajo që duhej të prijë», mëson shoku Enver.

Propaganda priu edhe për fuqizimin e përhapjen e lëvizjes së re. Ajo gjeti shprehjen e vet në organizimin dhe ngritjen në një shkallë më të lartë të të gjitha formave, duke filluar nga bisedat, nga udhëzimi i punëtorëve në vendin e punës, nga skicimi i plotë dhe demonstrimi i propozimeve, nga kërkesat për mendime e vërejtje rreth këtyre problemeve. Rol të veçantë në propagandën e prodhimit luajti organizimi dhe gjallërimi i emulacionit socialist, sidomos i agjitacionit figurativ. Moto e propagandës së prodhimit u bë: të forcojmë ndër-gjegjen, të njohim ligjet e zhvillimit të prodhimit, të thellojmë njohjen e proceseve teknike e teknologjike, të kursejmë kohën e punës, të rrisim rendimentin duke i dhënë shoqërisë sa më shumë



Nëpërmjet këndit të propagandës së prodhimit përhapet përvoja e iniciatoreve.

prodhime me cilësi të lartë, me sa më pak shpenzime.

Edhe sot ndodhet në faqet e murit të uzinës parulla e madhe, e shkruar bukur e pastër: «Asnjë minutë kohë e humbur, asnjë vonesë në punë». Po vetëm kjo, apo parullat e tjera të përgjithshme si «Puna është nder e lavdi», «Koha është flori» nuk mund të bindin e të mobilizojnë si duhet punëtorët për plotësimin e detyrave konkrete në dobi të lëvizjes. «Veprimtaria e propagandës së partisë, — mëson shoku Enver, — është një zinxhir i tërë, që i bën të ndërgjegjshëm njerëzit, është pra një punë e rëndësishme edukative». «... Çështja e propagandës në prodhim, pra, nuk është diçka në

40079

LIBRERIA E SHTETIT
 SHKURTARË
 53-446

erë, ajo duhet organizuar në kohën e duhur dhe të përpunohet me ngritjen e nivelit kultural të njerëzve tanë, që këta të mos e kuptojnë atë si një parullë të thjeshtë, po si një detyrë me shumë përgjegjësi».

Duke vënë në jetë këto mësimë, në uzinë nisi të zhvillohej një propagandë e dëndur, e larmishme konkrete, e cila mbante parasysht veçoritë e njerëzve, kushtet e punës së secilit dhe synonte t'i mësonte e t'i mobilizonte ata, t'i udhëhiqte drejt e si duhet në lëvizjen «Maqinat të mos pushojnë».



Liri Kuka, një nga iniciatorët e para të lëvizjes «Maqinat të mos pushojnë» flet në qendrën e zërit mbi përvojën e punës së saj.

Parullat e përgjithshme u zbërthyen, u lidhën me uzinën, repartin, me rezultatet e punës së secilit. Kështu parulla «Koha është flori» u zbërthye me parullën «I lumtë shoqes Xhemile Jahja, e cila, duke shfrytëzuar kohën e punës, ka prodhuar 100 gjer 130 manikota».

Nëpërmjet agjitacionit figurativ, qendrës së zërit, konsultave, takimeve, sesioneve shkencore, përhapje shembulli e përvoja e më të mirëve, po edhe kritika nuk pushonte kur punët nuk ecnin.

Në repartin e derdhjes me presion shkeleshin rregullat e sigurimit teknik, nuk shfrytëzoheshin si duhet maqineritë. Atëherë ndërhyri propaganda e prodhimit, e cila ua bëri të qartë punëtorëve të atij reparti dhe gjithë kolektivit se si pasojë e shkeljes së rregullave të sigurimit teknik në përdorimin e maqinave, të cilat gjenden të afishuara, presat nuk punuan çdo ditë dhe si pasojë u dorëzuan X doreza dyersh më pak se plani.

Një shkurt të këtij viti organizatat e bashkimeve profesionale të rrethit të Tiranës ndërmorën aksione me goditje të përqëndruar për të përmirësuar brenda 8 orëve ambientet politike dhe kulture. Uzina «Dajti» u shqua. Ndër të tjera, aksioni i shërbeu asaj për të shtuar numrin e parullave në ndjekje të lëvizjes, për të përmirësuar qendrën e emulacionit, për të gjallëruar fletërrufetë, këndet e shtypit e të librit, fotoekspozitat, për të sistemuar lëndën e parë e materialet, për të lyer me bojë maqinat dhe për t'i siguruar e mirëmbajtur ato.

Tërë propaganda me shkrim e me gojë, në mbledhje të gjera e në grupe punëtorësh, ashtu si agjitacioni i vogël individual, të cilit ju dha prio-

ritet, synonte t'i bënte punëtorët plotësisht të ndër-
gjegjshëm për thelbin, rëndësinë dhe dobinë e lëviz-
jes. Mbi të gjitha atyre ju shpjegua mësimi leni-
nist se rendimenti i punës është, në fund të fundit,
gjëja më e rëndësishme, gjëja kryesore për fitoren
e rendit të ri shoqëror, se ngritja e pandërprerë e
rendimentit të punës, si ligj ekonomik i socializ-
mit, është faktori vendimtar për shtimin e ritme-
ve të prodhimit, uljen e kostos, rritjen e akumu-
limit socialist dhe përmirësimin e nivelit material
të masave punonjëse.

Në bazë të gjithë kësaj pune u vu porosia e
shokut Enver: «Duhet t'i mësojmë njerëzit të për-
dorin në mënyrë racionale kohën, në punë dhe
jashtë punës, në shkollë dhe jashtë saj; ta bëjnë
një natyrë të dytë çështjen që kur është koha e
punës të punojnë me të gjitha forcat e tyre men-
dore dhe fizike, të jenë të disiplinuar, të respek-
tojnë normat dhe ligjet e punës; kur është koha e
pushimit të pushojnë, kur vjen koha e leximit të
lexojnë, kur vjen koha që të venë në teatër, në
kinema ose në sport të venë, kur vjen koha për të
fjetur të flenë».

E mbështetur në këtë porosi, propaganda sy-
nonte të rrënjoste në punëtorët konceptin e ri mbi
kohën, t'i bindte ata në teori e në praktikë se pu-
na, burimi i të mirave materiale, strumbullari i
jetës, e mëson, e forcon, e zbukuron njeriun,
farkëton karakterin e vërtetë, kalit ndërgjegjen
e pastër.

Duke vazhduar punën për kalitjen e ndër-
gjegjës revolucionare të punonjësve, organizata e
partisë dhe organizatat e tjera të masave në uzinë
nuk lanë pasdore organizimin konkret të punës.

Masat organizative-teknike u vlerësuan si materializim i orientimeve politike, si vendimtare për të vënë në jetë detyrat që shtronte lëvizja, sidomos në drejtim të forcimit të disiplinës proletare.

Kolektivi i ri i uzinës së re nuk u pri nga numri i fakteve dhe i shifrave, po bëri përgjithësimin e tyre, zbuloi shkaqet ekonomike, shoqërore, politike e ideologjike, duke ruajtur prioritetin e politikës mbi ekonominë. Si mbështetje e fuqishme në këtë drejtim shërbeu njohja e ligjeve ekonomike, mbi bazën e të cilave zhvillohet ekonomia jonë, pa lënë mënjanë zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore, që rregullojnë marrëdhënjet juridike në sferën e prodhimit e të shpërndarjes, mbrojnë jetën, shëndetin, të drejtat e punonjësve dhe pronën tonë socialiste. Për problemet e organizimit të prodhimit, në mënyrë të veçantë për shfrytëzimin në maksimum të kohës së punës dhe të maqinerive, u fol jo vetëm teorikisht e në përgjithësi, po parimet u lidhën me ndodhitë konkrete nga puna në uzinë.

Si kurdoherë, edhe në rastin e thellimit të përmbajtjes dhe të përhapjes së lëvizjes «Maqinat të mos pushojnë» disiplina nuk u kuptua thjesht si një normë që ka të bëjë me ardhjen dhe largimin në orar nga puna. Asaj ju dha një kuptim më i gjerë, kuptimi që ka në të vërtetë, duke u vlerësuar si një normë që ka të bëjë me të gjithë veprimtarinë e punonjësve ndaj problemeve të prodhimit, me respektimin e ligjeve të teknikës e të shkencës në procesin teknologjik, me plotësimin e planit të furnizimit në kohë, sasi e cilësi, me respektimin e kontratave, me mirëmbajtjen e shfrytëzimin e maqinave, etj. Nga secili u kërkua të mbante që-

ndrim të ndërgjegjshëm ndaj detyrave të ditës, të ndjente përgjegjësinë, të mendonte edhe për të nesërmen, t'i përgjigjej flakë për flakë lëvizjes së re.

Me të drejtë administrata u vlerësua si «pravijë» e fuqishme e njerëzve, që luftojnë në frontin e krijimit të të mirave materiale.

Mund të ndodhte që maqina të ishte në gadi-shmëri, por, që të jepte prodhim, ajo duhej të «ushqehej». Prandaj u hodh parulla «Të kemi furnizim të rregullt me lëndë të parë e materiale, të forcojmë kooperimin brenda dhe jashtë uzinës, me qëllim që asnjë punëtor të mos bëjë ndalesa për mungesa subjektive».

Në luftën për të bërë që «Maqinat të mos pushojnë», secilit punëtor e repart ju bë e njohur detyra, tërë kolektivi u njoh me «hallet» e uzinës. Dhe nga secili u kërkua që të mobilizonte tërë energjitë, forcat e talentet në dobi të iniciativës.

Rol të rëndësishëm në organizimin socialist të punës dhe në forcimin e disiplinës proletare lojti kontrolli punëtor i ushtruar brenda dhe jashtë ndërmarrjes. Edhe në këtë rast u mbajt parasysh porosia e shokut Enver: «Udhëheqja e kontrollit nga ana e klasës punëtore dhe e Partisë mbi çdo gjë dhe mbi këdo, mbi kuadrot, forumet, administratat, komisionet, duhet të jetë e plotë, pa të çara vendimtare».

Lëvizja revolucionarizoi njerëzit, të cilët në luftë për të bërë që «Maqinat të mos pushojnë» u vunë në krye të detyrave. Po pati dhe nga ata që nuk lëvizën nga vendi, që vazhdonin «avazin» e vjetër, nuk ecnin me hapin e kolektivit e me vru-llin e uzinës. Atëherë ndërhyri kontrolli punëtor,

u përdor si armë e fuqishme kritika e autokritika.

Kur vetë vihesh në pozita revolucionare, e ke lehtë t'i kërkosh llogari shokut që ke në krah, në brigadë, në repart, në uzinë, t'i kërkosh llogari edhe drejtuesve, qofshin këta brenda ose jashtë ndërmarrjes, brenda ose jashtë qytetit ku jeton.

Këtë dëshmoi edhe puna për të fuqizuar e përhapur lëvizjen e re.

Byroja teknologjike do të ngrinte një eliograf. Kaluan ditë dhe puna nuk ecte. Atëherë në adresë të administratës, që nuk furnizonte pjesët e nevojshme për ngritjen e eliografit, u drejtuan fletërrufe, u ushtrua kontrolli punëtor, i cili shkundi pluhurin e burokratizmit, përmirësoi metodën dhe stilin e punës.

Rreth 50 për qind e realizimit të planit të uzinës është mbështetur në kooperimin me fabrikën e gozhdëve dhe të bullonave në Kavajë. Po ç'ndodhi? Disa nga drejtuesit e uzinës, në kohën që lëvizja po lulëzonte, nisën të pengonin, të mos zbatonin detyrimet e furnizimit. Gjendja ishte serioze. Një orë të qëndronte uzina pa punë ishte një lloj sikur lëvizja «Maqinat të mos pushojnë» të shuhej për një muaj me radhë, gjë që do t'i sillte dëm prodhimit, do të ndikonte keq në punëtorët.

A mund të lejohej kjo gjendje? U përdoren fletërrufetë, u organizuan ballafaqime, u sinjalizua dikasteri.

Të gjitha këto shërbyen për një drejtim operativ të lëvizjes jo vetëm nga organizatat e masave, po edhe nga drejtorja e uzinës, sidomos nga sektori i furnizimit. Secili punonjës i administratës, ashtu si çdo brigadier e shef reparti, nisi ta ndjen-

te si detyrë të rëndësishme kontributin për të gjallëruar e forcuar lëvizjen e re, për t'u frymëzuar e mësuar nga punëtorët, pjesëtarët e klasës që i jep tonin jetës. U hoq dorë nga puna e ngushtë, zyrtare, e kufizuar, u forcuan lidhjet midis punëtorëve dhe personelit inxhiniero-teknik, punëtorët e vjetër e të rinj u bënë një. Këto lidhje, ndër të tjera, shërbyen për të rritur shkallën e kualifikimit të punëtorëve nëpërmjet sistemit të patronazhit, për t'i bërë të rinjtë e të rejtat zotër të maqinave, të uzinës. Pa këto lidhje, pa përpjekjet e vazhdueshme të vetë të rinjve për të rritur aftësitë e tyre profesionale, zotimi «punëtorët të përvetësojnë dy profesione» do të mbetej në letër, vetë lëvizja do të shuhej si flakë kashte.

Dihet se që ta çosh përpara prodhimin, është e domosdoshme të përvetësosh teknikën moderne, të zotërosh të rejtat e shkencës, të thellosh çdo ditë njohuritë profesionale. Dhe kjo arrihet jo vetëm nëpërmjet shkollës e librave, po edhe nëpërmjet përvetësimit të përvojës së përparuar dhe praktikës revolucionare. Ja sepse punëtorët e uzinës «Dajti» vazhduan me zell të mësonin nga dy e më shumë profesione, duke ndjekur shembullin e sekretares së tyre Liri Hitocanit, e cila brenda një kohe të shkurtër arriti të përvetësonte tre profesione.

E pyet sekretaren mbi «sekretin» e suksesit dhe ajo të përgjigjet:

«S'ka asnjë sekret. Që të prodhosh, të ndërtosh e të krijosh duhet të dish, duhet të mësosh. Shoku Enver na mëson që në botëkuptimin e njerëzve tanë të krijojmë nevojën në jetë të të mësuarit, nevojën e

perfeksionimit të vazhdueshëm dhe jo vetëm në kuptimin e ngushtë, të vogël, egoist, për të fituar bukën, por në radhë të parë për të kuptuar e zotëruar shkencën e diturinë, për të transformuar natyrën për ta bërë të begatshëm atdheun dhe jetën e njerëzve.


Sa më i aftë të jetë punëtori nga ana tekniko-profesionale, aq më racionalisht ai mund të përdorë mjetet e prodhimit, materialet e lëndën e parë, aq më shumë do të rrisë rendimentin, do të përmirësojë cilësinë, do të ulë koston e prodhimit.

Ja sepse ne i vumë detyrë vetes të përvetësojmë nga dy e më shumë profesione dhe ja arritëm qëllimit».

Qartësia, vullneti, këmbëngulja janë kryesore në jetë. Këto cilësi karakterizojnë të rinjtë e punëtorët e tjerë të uzinës. Dhe ja përfundimi: brenda një kohe rekord 34 punëtorë u ngritën në kategori, arritën të zëvendësonin për bukuri punëtorët me kategori të lartë e me përvojë në drejtimin e maqinave.

«T'i ngremë të gjithë punëtorët në një nivel të lartë teknik, t'i bëjmë ata të mësojnë dy dhe më shumë profesione». Duke vënë në jetë këtë parullë, në uzinë u ngrit shkolla e mesme profesionale me 4 klasa, të cilën e ndoqën mbi 100 vetë, u shtuan kurset e kualifikimit, u pasurua dhoma e përparimit teknik, u organizuan konsulta e sesione shkencore brenda dhe jashtë uzinës, u përhap si asnjëherë tjetër shembulli i njerëzve me përvojë në mbajtjen në gadishmëri të maqinave dhe në shfrytëzimin e plotë të tyre. Përvoja e Xhafer Topçiu dhe e Ramazan Mënikut në repartin e remontit, e Xhemal Ibrahimit, e Ramazan Begës, e Hatixhe

Kallushit dhe e Liri Hitocanit në repartin e veglave e të stampave, mbi të gjitha përvoja e luftëtarëve të lëvizjes «Maqinat të mos pushojnë» si e Zenepe Salës, Shaniko Osmanit, Liri Kukës, Shpresa Limës dhe Xhemile Jahjës u bë e njohur në tërë kolektivin.



Iniciatoret Xhemile Jahja dhe Liri Kuka gjatë punës në presat e plasmasit.

Krahas përhapjes së shembullit të mirë u kritikuan mendimet e gabuara «ç'më duhet shkolla kur kam zanat, kur paguhem sipas vendit të punës» etj.

Edhe në këtë drejtim priu shembulli i komunistëve. Komunisti jep i pari shembullin e mirë në punë e në mësim, nxit të tjerët për të vepruar

si ai për të ndërmarrë iniciativa, lëvizje dhe akcione të guximshme. Ai është njeri i fjalëve të zjarrita dhe i veprave revolucionare, i pregatitur ideologjikisht e politikisht, që, kur flet, ngre peshë të gjithë ata që e dëgjojnë. Ai u flet njerëzve hap-tazi e pa doreza. Ata që nuk i kuptojnë çështjet, i ndihmon me durim e takt t'i kuptojnë në rrugën e partisë, të rregullave, të moralit shoqëror.

Përgjithësisht në përkrahjen e lëvizjes komunistët dhe gjithë aktivistët u karakterizuan nga puna e palodhur për të bindur njerëzit mbi dobinë e saj, nga lufta e parreshtur kundër formave e metodave të vjetra që pengonin. Ata të parët sugjeronin e kritikonin hapur e pa ndrojtje me qëllim që gjithë kolektivi të përfshihej në lëvizjen «Maqinat të mos pushojnë», të frymëzohej në teori e në praktikë nga lufta për t'i dhënë shoqërisë sa më shumë, sa më mirë, sa më lirë.

TE GJITHË KANE Ç'TË MËSOJNË

Puna për të krijuar te secili bindje të forta ideologjike, e shoqëruar kjo me masa tekniko-organizative, ja arriti qëllimit: Lëvizja e lindur në repartin e presave u përhap në tërë uzinën. Luftë-taret e saj, duke shtruar problemin «Maqinat të mos pushojnë», vunë në lëvizje mendimin kryesor të gjithë kolektivit, mobilizuan energjitë e aftësitë e tij në shumë drejtime.

Në këtë mënyrë u përmirësua ritmika e realizimit të planit dhe cilësia, të gjithë sektorët u hodhën në luftë për të ngritur linja të reja, për të mekanizuar procesin e prodhimit, për të kërkuar for-

ma të reja pune dhe organizimi, për të kaluar nga prodhimi i vjetër artizanal në prodhim në linjë. Me punë krijuese, vetëmohuese dhe të organizuar u ngritën linjat e ganxheve të izolatorëve, e valvove të kasetave dhe sustave të divanit. Në krahasim me vitin 1968, uzina shtoi prodhimin e përgjithshëm 3 herë, numrin e operacioneve nga 22 milion në 60 milion, të detaleve nga 4 milion në 12 milion, të artikujve të rinj nga 15 në 64 milion.

Rritje të madhe patën artikujt kryesorë. Kështu, në krahasim me vitin 1968, më 1970 bravat e dyerve u rritën 4 herë (në vitin e ardhshëm do të rriten 8 herë), ganxhat e izolatorit për elektrifikimin e fshatit 6 herë, shulat e dritareve 8 herë,



Artikuj të rinj të prodhuar në uzinën e re «Dajti»

spangoletat e dritareve 2 herë. Veç këtyre, uzina prodhoi artikuj të tjerë të imtë metalikë ndërtime, si rubineta, saraçineska, mistri muratori. Vetëm mentesha dhe inklizina uzina prodhon sot rreth 2 milion copë.

Plani i 6-mujorit të parë të vitit 1970, vit i sulmit revolucionar të paparë gjer më sot në të gjitha drejtimet, u plotësua 104 për qind, rendimenti u rrit 10 për qind. Lëvizja «Maqinat të mos pushojnë» ndikoi drejt për së drejti në rritjen e shkallës së shfrytëzimit të maqinave dhe të rendimentit për çdo maqinë dhe bëri të mundur që punëtorët të zotëronin më shumë se dy profesione.

Duke bërë fjalë për dobinë e lëvizjes së re, sidomos në drejtim të kualifikimit të punëtorëve, Katerina Oroshi, nënkryetare e komitetit profesional të uzinës, thotë:

«Ne kemi të rinj të mrekullueshëm. Edhe punëtorët e punëtorët e moshuar, të gjithë kolektivin e kemi të tillë. Të gjithë te ne e kanë të qartë se për ta çuar përpara prodhimin është e domosdoshme të përvetësosh teknikën moderne, të zotërorsh të rejat e shkencës, të thellosh çdo ditë njohuritë profesionale. Dhe kjo arrihet nëpërmjet shkollës e librave, po edhe nëpërmjet përvetësimit të përvojës së përparuar. praktikës e punës revolucionare.

Ne jemi munduar të përfitojmë nga përvoja e të tjerëve. Kemi ndjekur me vëmendje përvojën e uzinës «Partizani» mbi përparimin teknik dhe jemi munduar të përfitojmë sa më shumë nga ajo. Lidhjet e ngushta me personelin inxhiniero-teknik dhe me punëtorët e uzinës «mëmë», na kanë frymëzuar në punën tonë. Në qendër të vëmendjes

sonë kanë qëndruar e vazhdojnë të qëndrojnë edhe lëvizjet «Vrojto, zbullo, korigjo». «Brigadë, repart e ndërmarrje e edukimit revolucionar dhe e rendimenteve të larta», e të tjera.

Po ne na vjen keq që lëvizja jonë gjer tani ka mbetur si jetime. Mos vallë quhet ajo e «vogël», pak e rëndësishme? Ta zëmë se është kështu. A nuk përbëhet e «madhja» e «rëndësishmja» nga të «voglat»? Edhe organizimi i vogël quhet i tillë, po ka rëndësi të madhe, sepse, ashtu siç mëson shoku Enver, këtu kullon djersa, këtu është kudhura, këtu kalitet çeliku, këtu duhet të përqëndrohet i gjithë kujdesi, të gjejë zbatim puna politike dhe ideologjike, këtu tregohet dhe vërtetohet organizimi i mirë, njihen më mirë se kudo njerëzit e klasës, disiplina e klasës, ndërjegjja e klasës.

Ja sepse, duke luftuar për shfrytëzimin e kohës së punës e të maqinerive, ne i kemi kushtuar kujdes pikërisht «organizimit të vogël» që është aq i rëndësishëm për prodhimin e madh.

Po e përsëris, ne na vjen keq që lëvizja jonë nuk po gjen përhapjen e duhur».

Po kështu shprehet edhe sekretari i organizatës bazë Hase Mane:

«Lëvizja jonë «Maqinat të mos pushojnë» ka mundësi të shtrihet kudo ku ka seri të madhe prodhimi, kudo ku përdoren instrumentë speciale, të cilët zëvendësojnë punën e njerëzve, si në uzinat «Enver», «Partizani», «Dinamo», përgjithësisht në industrinë mekanike dhe në ndërmarrjet e prodhimit të konsumit të gjerë të Tiranës edhe të mbarë vendit. Sidoqoftë, edhe sikur lëvizja «Maqinat të mos pushojnë» të vihet në jetë vetëm në repartet

speciale, punëtorët e tjerë kanë ç'mësojnë nga përvoja jonë».

Po, të gjithë kanë ç'të mësojnë nga lëvizja «Maqinat të mos pushojnë».

Punëtorët e rinj të uzinës së re janë njerëz që kanë përveshur llërët, që u punon mendja e dora. Ata, duke mos njohur ndrojtjen e frikën, duke luftuar e mposhtur vështirësitë e rritjes, të ecjes përpara, i hapën rrugë lëvizjes së re.

Rruga u hap. Tani mbetet që lëvizjes së tyre «Maqinat të mos pushojnë» t'i hapen dyert edhe në uzinat e fabrikat e tjera, në çdo repart e ndërmarrje, ku janë mundësitë. Edhe në qoftë se ato s'kanë «seri të mëdha prodhimi», instrumentë e reparte «specialë», kanë po ato probleme të mëdha, të cilat kolektivi i uzinës «Dajti» po i zgjidh me sukses. në rrugë revolucionare.

Njerëzit e uzinës së re i ndriçon mësimi i shkollës Enver se si çdo revolucion tjetër edhe «*revolucionin tekniko-shkencor do ta bëjnë masat*». Duke pasur si busull këto mësimet, lëvizjes «Maqinat të mos pushojnë» ja hapën rrugën jo disa «figura» të njohura, disa «talente» të rralla, po vetë punëtorët, të rinjtë, të rejtat, gratë, në lidhje të ngushtë me personelin inxhiniero-teknik, duke vlerësuar si kryesore ndihmën dhe bashkëpunimin reciprok.

Punëtorët njihen mirë me problemet e uzinës. Gofshin këto të karakterit tekniko-teknologjik apo ekonomik-organizativ. Sa herë vjen fjala për vështirësitë, në uzinë të thonë: «Po nuk i njeh ato, nuk mund të luftosh e të fitosh mbi to. Në frontin e prodhimit është njëlloj si në frontin e luftës. Njohja e mirë e gjendjes së forcave të armikut është kusht për të sulmuar e fituar mbi to».

Këto parime teorike në uzinë gërshetohen më së miri me jetën, me zbatimin praktik të politikës së partisë në prodhim.

Të caktosh objektivin është lehtë, po ta arrish atë, kjo është kryesorja. Kolektivi i uzinës së re e ka bërë si rregull: cakton një objektiv dhe mënjëherë shtron pyetjen se si mund t'i arrihet atij më shpejt e më lehtë, jo duke pritur nga «lart» apo nga «jashtë», siç ndodh disa herë, por duke u mbështetur në forcat, mjetet, mundësitë e kushtet e veta. Kështu ndodhi edhe me lëvizjen e re. Sa po lindi ajo, organizata bazë e partisë, e bashkimeve profesionale, e bashkimit të rinisë si edhe drejtoria u kapën pas hallkës kryesore: punës për përgatitjen ideologjike të punëtorëve. Për to ishte e qartë se vetëm punonjësit e brumosur me tiparet e reja ideologjike e morale të klasës, me botëkuptimin e ri mund të kuptonin thelbin e lëvizjes, të dashuronin punën, të shfrytëzonin në mënyrë racionale kohën, të vlerësonin maqinat si pjesë përbërëse të pronës së tyre, të të gjithë shoqërisë. Vetëm me një punë të gjithanshme, të dendur dhe të organizuar politike u arrit të hidhet poshtë me përbuzje çdo ndjenjë mosbesimi në energjinë, në forcën e në mendimin krijues të masave, vetëm në këtë mënyrë u bë e mundur të thyeshin konceptet «s'ka mundësi», «mungojnë kushtet», të cilat ndrydhnin iniciativën krijuese të masave, frenonin zhvillimin e mendimit revolucionar. E reja triumfoi mbi të vjetrën, te çdo punëtor, teknik e inxhinier i uzinës u forcua bindja në forcat e veta e të kolektivit, u forcua pasioni për dijen, prirja për të menduar për sot e për nesër, guximi e këmbëngulja për të marrë përsipër probleme të

rëndësishme të prodhimit dhe për t'i zgjidhur gjer në fund ato. Kjo u arrit sepse puna për zbërthimin ideologjik të lëvizjes, për t'i bindur çjerëzit u shoqërua në çdo hap me organizimin, me disiplinën proletare në plotësimin e detyrave. Partia jonë është udhëhequr vazhdimisht nga mësimi leninist se zhvillimi e forcimi i disiplinës shoqërore të punonjësve, ngritja e gjithanshme e vetëveprimit të tyre dhe e kuptimit të përgjegjësisë është mjeti më i rëndësishëm, në mos i vetmi mjet për të zhdukur deri në fund kapitalizmin dhe zakonet që ka krijuar sundimi i pronës private mbi mjetet e prodhimit. Plenumi i 10-të i Komitetit Qendror të PPSH theksoi përsëri se organizimi socialist i punës dhe disiplina proletare janë vendimtare për të zbatuar vijën e drejtë politike, për të zgjidhur problemet e mëdha të prodhimit, të ndërtimit socialist të vendit.

Lufta për të forcuar organizimin socialist të punës në uzinën «Dajti» u fillua nga «gjërat» që në pamje të parë të duken «të vogla», «të parëndësishme». Me të drejtë u mbajt parasysh proverbi «gur gur bëhet mur», fakti se e madhja, e rëndësishmja përbëhet nga «të voglat», «pak të rëndësishmet». Në këtë drejtim ju kushtua kujdes i veçantë «organizimit të vogël» të punës, i cili është i lidhur drejtpërdrejt me rendimentin e punës.

Ligji i rritjes së rendimentit, i rritjes së prodhimit në njësi kohe kërkon patjetër që çdo punëtor të kursejë kohë dhe mjete. Në këtë kuadër u shtrua detyra që maqinat të mbareshin në gadi-shmëri të plotë, të pastroheshin, të vajiseshin, të riparoheshin në rregull. Të gjitha këto bënë që maqinat të mos pushojnë.

«Maqinat të mos pushojnë» është një lëvizje krijuese. Ajo dëshmon se cilido punëtor prodhimi, teknik apo inxhinier, punonjës i thjeshtë i administratës apo kuadër drejtues mund të punojë, të shpikë apo të përmirësojë në dobi të prodhimit; puna është që të vihet në lëvizje mendimi krijues, të tregohet merak për problemet që kërkojnë zgjidhje, të zbulohen mundësi e rezerva të reja, të vlerësohen e të përdoren me arësye ato.

Lëvizja «Maqinat të mos pushojnë» shtron shumë detyra në fushën e organizimit dhe të drejtimit. Mund të ndodhë që një lëvizje, nga mungesa e masave të pamjaftueshme organizuese, të mbetet në mes të rrugës. Puna organizuese e drejtuese është e gjithanshme, që nga shpjegimi e dhënja e njohurive njerëzore mbi mënyrën e zbatimit e deri në plotësimin ritmik të vendeve të punës me materialet e nevojshme. Vetëkuptohet se edhe personeli inxhiniero-teknik dhe administrativ ka detyra të shumta për të vënë në jetë një iniciativë, qoftë kjo e «madhe» apo e «vogël». Ky moment i organizimit e i drejtimit të prodhimit shoqëror është vlerësuar drejt nga punonjësit e uzinës «Dajti», që merren para së gjithash me veprimtari organizuese e drejtuese. Këta u frymëzuan nga lëvizja «Maqinat të mos pushojnë», e mbështetën fuqimisht atë. Kjo ndodhi edhe sepse «prapavija», sidomos sektori i furnizimit, ju nënshtrua gjykimit kolektiv, kritikës e sugjerimit të tij. Kontrolli punëtor nuk lejoi që shkëndia e ndezur të shuhej, që zëri i të rinjve, i të rejave, i vajzave e grave, propozimet e sugjerimet e kolektivit të mbylleshin nëpër sirtaret e ndonjë shefi kryetari apo drejtori, qofshin këta brenda ose jashtë ndërmarrjes. Për

cilindo u bë e qartë se te ne nuk ka dy disiplina, një për punonjësit e tjetra për drejtuesit, se zgjidhja e drejtë e detyrave që shtronte lëvizja kërkonte interesim e përgjegjësi të plotë, duke filluar nga drejtori gjer te portieri i ndërmarrjes.

A nuk janë të gjitha këto mësimet me vlerë? «Maqinat të mos pushojnë» është një lëvizje me përmbajtje të thellë patriotike-revolucionare, luftëtarët e saj janë njerëz me ndërgjegje të lartë, me horizont e botë të gjerë, nga përvoja e të cilëve kushdo ka ç'të marrë, kushdo ka ç'të mësojë.

PËRMBAJTJA

Njerëz të rinj të uzinës së re	5
Propaganda prin	16
Të gjithë kanë ç'të mësojnë	27

1900

1

1900

2

1900

3

1900

Tirazhi 2000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp. NISh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1970